

INTERNET AND LITERATURE

Emine SHABANI¹

¹Gjuhë dhe letërsi shqipe – Fakulteti Filologjik, Universiteti i Tetovës
e-mail: emine.shabani@unite.edu.mk

Abstract

The theme of the Internet and the book inevitably implicates social networks, writing, online libraries, various book sites, such as amazon kindle, google books where we can create our own electronic library and explore various topics. Physical book or e-book? With the advancement of technology, the issue of the physical book remains unquestioned! In specific cases the e-book takes precedence over the physical one, because on a small tablet we can load dozens of books that we carry with us everywhere. While the physical book gives you the pleasant feeling of browsing noise, the smell of paper, but also the convenience of reading. The positive and negative sides of the internet as a necessity of the time? With the development of e-libraries we gain space, read from the computer and are able to find a large number of books that were previously impossible, but also abuse of copyright by downloading, copying and multiplying them.

Keywords: e-books, academic libraries, electronic science journals, science-fiction books.

1. Interneti dhe letërsia

Shkrimtari anglez i shek. XIX dhe fillimviteve të shek. XX Herbert George Wells, i njohur për veprat letrare fiktive, por më i shquar si kritik shoqëror largpamës, madje profetik, i cili ia kushtoi talentin e tij letrar zhvillimit të një vizioni përparimtar në një shkallë globale. Si futurist, ai shkroi një numër veprash utopike dhe parashikoi shpikjen e avionëve, tankeve, udhëtimit në hapësirë, armëve bërthamore, televizionit satelitor dhe diçkaje që i ngjan ueb faqeve botërore. Në fiksionet e tij shkencore imagjinonte udhëtimin në kohë, pushtimin nga jashtëtokësorët, padukshmërinë e njeriut dhe inxhinierinë biologjike. Brian Aldiss-i i referohej Wells-it si "Shekspiri i trillimit shkencor". Wells-i bëri veprat e tij bindëse duke futur detaje të zakonshme së bashku me një supozim të vetëm të jashtëzakonshëm - të quajtur "ligji i Wells-it" - duke bërë që Joseph Conrad në vitin 1898, ta quante atë si "Realist i fantastikes!". Punimet e tij më të shquara të trillimeve shkencore janë *Makina e kohës* (1895), *Ishulli i Doktor Moreau-t* (1896), *Njeriu i padukshëm* (1897), *Lufta e botëve* (1898) dhe fiksionet me tema lufte si *Lufta në ajër* (1907).

Ai kishte talente në shumë zhanre, romane, tregime, vepra me karakter shoqëror, historik, satira, biografi, autobiografi dhe dy vepra me luftëra fiktive galaktike. Kritikët e krahasojnë me Jules Vern-nin dhe Hugo Gernsback-un. Në historinë e mëhershme të njerëzimit ekzistojnë edhe emra vizionarësh të tjerë që kanë parashikuar të ardhmen me teknologji shumë të zhvilluar, por përkras kësaj teknologjie edhe njerëz që do të krijojnë monopole dhe, të atillë që do ta keqpërdorin atë. Oldous Huxley, Georg Orwell, Evgenij Zamjatin, Jack London, etj, që në veprat e tyre mbi të ardhmen e njerëzimit, theks të veçantë i kanë vënë përparimit teknologjik dhe degradimit shpirtëror nga ana tjetër, ose vdekjes shpirtërore. Ata përpunojnë ato elemente distopike në veprat

e tyre të cilat në kohën tonë janë kthyer në modë! Një ndër filozofët e shek. 20 Emanuel Munie e quajti “modë absurde e shekullit të 20-të”.¹

Si vizionar i së ardhmes, Wells, parashikoi një enciklopedi botërore të përhershme, të ashtuquajtur *Truri Botëror*, në të cilën do të kishte qasje gjithkush.

Kontributi i tij në Enciklopedinë e re franceze, gusht 1937:

*Është e mundshme që ideja e një enciklopedie mund të pësojë një shtrirje dhe shtjellim shumë të konsiderueshëm në të ardhmen e afërt. Enciklopeditë e së kaluarës kanë mjaftuar për nevojat e një pakice të kultivuar. Ata u shkruan "për zotërinjtë nga zotërinjtë" në një botë ku arsimi universal ishte i parëndësishëm, dhe ku institucionet e demokracisë moderne me votim universal, aq të domosdoshëm në shumë aspekte, aq të vështira dhe të rrezikshme në punën e tyre, duhej të shfaqeshin përsëri. Gjatë gjithë shekullit të nëntëmbëdhjetë enciklopeditë pasuan shkallën dhe modelin e shekullit të tetëmbëdhjetë, me gjithë një rritje gjigande të njohurive të regjistruara dhe një rritje akoma më gjigante në numrin e njerëzve, që kërkojnë informacion të saktë dhe lehtësisht të arritshëm. Ndërmarrja enciklopedike nuk ka mbajtur ritmin e përparimit material.*²

Interneti si shpikje gjeniale e shekullit, i ka i ka ndihmuar artit, shkencës, enciklopedive të popujve të botës, në përhapjen e informacionit, komunikimit, hulumtimit, ueb faqeve me libra të vjetër, bibliotekave elektronike, etj. Pasi që interneti është produkt i një teknologjie shumë të përparuar, me anë të të cilit japim dhe marrim informacione, me shpejtësi dhe lehtësi, në fund të fundit ai i ka të dy anët e medaljes. Por, së pari po i radhis përparësitë e tij. Gjatë mijëvjeçarëve nga veprat e autorëve antikë, dimë që nga 90 tragjeditë e Eskilit kanë mbetur vetëm shtatë, shumë vepra të Aristotelit dhe Sofokliut janë zhdukur, etj.

Ekspertët amerikanë po bëjnë përpjekje t'i lexojnë dhe deshifrojnë librat e djegur të bibliotekës së Herkulaneumit të cilat janë pjesërisht të djegura ose të karbonizuara por të mbështjella rrotull dhe të paprishura që nga shpërthimi i Vezuvit në Pompei dhe qytetin bregdetar të Herkulaneumit më 17 tetor të vitit 79 p. K. Shkencëtarët janë përpjekur t'i deshifrojnë këto tekste me anë të teknologjive joinvazive si rrezet X, fotografia dixhitale dhe mikroskopia. "Rezultatet tregojnë se është e mundur të lexohet *papyri Herkulaneum* pa pasur nevojë të hapen ato, që gjithnjë përfshin rrezikun e dëmtimit dhe humbjes së përmbajtjes," thotë Vito Mocella nga Këshilli Kombëtar i Kërkimit në Itali, i cili udhëheq projektin. Shumë nga kryeveprat letrare të botës antike mbeten të humbura - për shembull, vetëm shtatë nga 123 shfaqjet e supozuara të Sofokliut që sot ekzistojnë. Aty është gjetur një vepër e panjohur e Filodemit dhe disa vepra të Epikurit, gjithashtu arkeologët shpresojnë se ndoshta mund t'i gjejnë veprat e zhdukura të Aristotelit, tragjeditë e humbura të Eskilit, etj. Mbetet për t'u parë se cilat vepra të panjohura mund të qëndrojnë në mesin e papiruseve të palexuara të Herkulaneum. Por sipas Mocellës, ekziston një mundësi e vërtetë për ta rikthyer klasikën e zhdukur të letërsisë antike. Me anë të kësaj teknologjie, shkenca do t'i kishte ndihmuar artit, në përgjithësi, si dhe shkencave tjera natyrore.³

¹Revista shkencore arkeologjike “online” <https://www.archaeology.org/news/2908-150120-herculaneum-papyri-imaging>.

² A Global Encyclopedia of Historical Writing, Volume 2, edited by D.R. Woolf, Garland Publishing INC, New York & London 1998, f. 940.

³ <https://www.archaeology.org/news/2908-150120-herculaneum-papyri-imaging>.

Si mbledhja, ashtu edhe shpërndarja e njohurive në botë aktualisht janë jashtëzakonisht joefektive, dhe mendimtarët e tipit largpamës idetë e të cilëve ne do ti shqyrtojmë tani, kanë filluar të kuptojnë se linja më shpresëdhënëse për zhvillimin e inteligjencës njerëzore, qëndron në drejtimin e krijimit të një organi të ri botëror për mbledhjen, indeksimin, përmbledhjen dhe shpërndarjen e njohurive, sesa në ndonjë ndërhyrje të mëtejshme në sistemin universitar shumë konservator dhe rezistent, lokal, kombëtar dhe tradicional në cilësi, i cili tashmë ekziston. Këta novatorë, të cilët mund të jenë ëndërrimtarë sot, por që shpresojnë të bëhen nesër organizatorë shumë aktivë, projektojnë një organ të unifikuar, nëse jo edhe të centralizuar botëror për të "tërhequr vëmendjen e gjithë botës së bashku", i cili nuk do të jetë rival për universitetet, por shtesë plotësuese dhe bashkërenduese dhe ndihmëse e veprimtarive të tyre arsimore, në një shkallë planetare.

Shprehja "Enciklopedi Botërore e Përhershme" përcjell thelbin e këtyre ideve. Thelbi i një institucioni të tillë, do të ishte një sintezë planetare e bibliografisë dhe dokumentacionit me arkivat e indeksuara të botës.

Pak njerëz, akoma, përveç bibliotekarëve, ekspertëve dhe kuratorëve të muzeve, e dinë se si mund të rregullohen mirë faktet, sado të shumta në numër të jenë dhe sa shpejt e plotësisht mund të jenë vendosur në një skemë të rregulluar të referencave dhe riprodhimit. Ekspertët amerikanë të mikrofilmit, madje edhe tani, janë duke bërë faksimile të librave më të rrallë, dorëshkrime, fotografi dhe ekzemplarë, të cilat më pas mund të bëhen lehtësisht të arritshme në biblioteka. Me anë të mikrofilmit, dokumentet dhe artikujt më të rrallë e të ndërlikuar mund të studiohen në dorën e parë-të origjinalit, në të njëjtën kohë vetëm nga një dhomë e projeksionit. Nuk ka asnjë pengesë praktike krijimi i një indeksi efikas për të gjitha informacionet, dijet, idetë dhe arritjet njerëzore, për krijimin e një memorie të plotë planetare për të gjithë njerëzimin. Një mikrofilm, me ngjyrë kur është e nevojshme, duke zënë një inç apo më shumë, e që peshon pak më shumë se një letër, mund të kopjohet nga procesverbalet dhe të dërgohet kudo, të prezantohet i zmadhuar në ekran, që studenti të mund ta studiojë në çdo detaj.

Ky është një fakt me rëndësi të jashtëzakonshme. Parashikon një unifikim të vërtetë intelektual të racës njerëzore. E gjithë kujtesa njerëzore mund të jetë, në një kohë të shkurtër e arritshme për çdo individ. Është me rëndësi shumë të madhe në këtë botë të pasigurt, ku shkatërrimi bëhet vazhdimisht më i shpeshtë dhe i paparashikueshëm, është kjo fotografia që na mundëson lehtësisht shumëzimin dhe dyfishimin e asaj që mund ta quajmë tru i ri gjithënjënjëzë. Nuk ka nevojë të përqendrohet në asnjë vend të vetëm. Mund të riprodhohet saktësisht dhe plotësisht, në Peru, Kinë, Islandë, Afrikën Qendrore, ose kudo tjetër duket dhe mund të sigurohet nga rreziku i ndërprerjes. Mund të ketë njëkohësisht, përqendrimin e një qenieje gjigante dhe gjallërinë e shpërndarjes së një amebe.

Kjo nuk është ëndërr e largët, nuk është fantazi, është një deklaratë e qartë e aktualitetit bashkëkohor. Është nivel i faktit të praktikueshëm. Është çështje me rëndësi dhe dëshirë të dukshme për shkencën, për nevojat praktike të njerëzimit, për arsimimin e përgjithshëm, që është e vështirë të mos besosh që në një të ardhme të afërt, kjo *Enciklopedi Botërore e Përhershme*, kaq

kompakte nga ana materiale dhe kaq gjigante në shtrirjen e saj dhe ndikimin e mundshëm, nuk do të ekzistojë.

Përdorimet e saj do të jenë të shumta dhe të dukshme. Seksione të veçanta të saj, historike, teknike, shkencore, artistike, p.sh. do të riprodhohen lehtësisht për përdorim specifik profesional. Bazuar në këtë seri përmbledhjet do të jenë të dobishme për studime dhe hulumtime të shkencëtarëve, të dobishme edhe për njerëzit e thjeshtë, për kolegjet, shkollat dhe universitetet, këto materiale, do të mund të merren dhe të rishikohen vazhdimisht. Në duart e redaktuesve kompetentë, drejtorëve të arsimit dhe mësuesve, këto kondensime dhe abstrakte të përfshira në sistemin arsimor botëror, do ta furnizojnë njerëzimin në një të ardhme të afërt, me një mirëkuptim dhe konceptim të përbashkët të një Commonwealth-i që ne tani nuk mund ta imagjinojmë. Dhe krijimi i saj është një mënyrë për ta ruajtur, paqen në botë e cila mund të ndiqet pa ndonjë rrezik të mundshëm, të parandalojë përplasjen me forcat politike ndërluftuese dhe interesat institucionale të ditëve të sotme. Në mënyrë të qetë dhe pedante kjo enciklopedi e re, do t'i kapërcejë këto mospërputhje arkaike, duke i privuar ato në mënyrë të qëndrueshme, nga realiteti aktual. Një ideologji e thjeshtë që bazohet në këtë *Enciklopedi Botërore të Përhershme* është një mjet i mundshëm dhe mënyra e vetme, për asgjësimin e konfliktit në bashkësinë njerëzore.⁴

Ky konkretisht është objektiv i matur, praktik, por në thelb kolosal i atyre që janë duke kërkuar sot, ta sintetizojnë mentalitetin njerëzor përmes këtij zhvillimi natyror dhe të arsyeshëm, të enciklopedizimit në një *Enciklopedi Botërore të Përhershme*.

Njëkohësisht me këto realizime ka një pakënaqësi në rritje me rolin që luajnë universitetet, shkollat dhe bibliotekat në jetën intelektuale të njerëzimit. Universitetet shumohen, shkollat e çdo klase dhe lloji rriten, por ato nuk e zgjerojnë qëllimin e tyre në asgjë, siç janë kërkesat urgjente të kësaj epoke të trazuar dhe të rrezikshme. Ata nuk e kryejnë detyrën dhe as ushtrojnë autoritetin që në mënyrë të arsyeshme të mund t'i atribuohen organizimit të mendimit dhe dijes së botës. Nuk është gjithçka ashtu siç duhet të jetë, universitetet më të mëdha dhe më të fuqishme po bashkëpunojnë gjithnjë e më intimisht, dhe nga ana tjetër shumë universitete të tipit të vjetër, kryesisht në mënyrë të paarsyeshme, mbajnë nivelin e vjetër arsimor.

Skica e historisë, ideja e një enciklopedie botërore të përhershme (1937) u botua nga Wells-i jo vetëm në *Enciklopedi Française*, por edhe në vëllimin "*Truri botëror*", ku mblodhi punime dhe adresa të ndryshme në lidhje me edukimin dhe marrjen e informacionit. Nëse thjesht ndryshoni 'mikrofilmin' në 'skedarë kompjuteri', është e mahnitshme sa e saktë ishte profecia e Wells-it.⁵

Në vazhdim janë mendimet e disa studiuesve për faktin se leximi në internet u ka ndryshuar mënyrën e mendimit dhe, kjo duket se është një nga shenjat shqetësuese për humbjen e dëshirës për të lexuar një libër fizik dhe gatishmërinë madje edhe babëzinë për marrjen e informative të gatshme nga interneti dhe këta janë shkencëtarë, mendimtarë e studiues me zë të cilët po i rrëfejnë ndryshimet që ka bërë interneti tek ata. Këto ndryshime mendoj se kanë një efekt psikologjik i cili krijon një varshmëri, për të marrë më të lehtë, pa u lodhur, me fjalë të tjera një ndër elementet

⁴McLuhan, Marshall, (1975), *Understanding Media The extensions of man*, London and New York. f. 74.

⁵ Marshall McLuhan, (1975), *Understanding Media The extensions of man*, London and New York. f. 77.

e shumta të distopisë, rendja pas gjërave lehtësisht të arritshme, duke mos menduar për pasojat shëndetësore e fizike të njeriut.

Natyrisht që rrjetet sociale dhe portalet e ndryshme abuzojnë dhe shpërndajnë lajme të rrejshme, dezinformata e shtrembërime të deklaratave, siç deklaroi në një rast Umberto Eco: Nga shtatë miliardë njerëz që ka planeti, me siguri nja treqind milion mund të jenë idiotë, që i shtrembërojnë komentet. Sokrati te Fedra e Platonit parashikoi: “Njerëzit do të bëhen dëgjues të shumë gjërave dhe, nuk do të mësojnë asgjë”. Me këtë kam për qëllim të radhis edhe anët negative që mund të thuhet për internetin. Do të doja të bëj një paralelizëm me thënien e Gëtes te Fausti. Mefistofeli iu lut Zotit ta çojë në paudhën e tij Faustin, por ai iu përgjigj: “Robin tim Faustin në paudhën tënde, e çon vetëm pavetëdija”. Ne shpesh u themi studentëve, kompjuteri shërbëtor apo diktator? Dhe varet nga vetëdija jonë, n.q.s. do të bëhemi rob i këtij aparati teknologjik, apo ta vëmë atë në shërbimin tonë!

Disa nga disavantazhet e qëndrimit të tepruar në kompjuter dhe telefonat celularë, janë: humbja e kohës, bulizmi kibernetik (nga grup-moshat e njëjta), degjenerimi moral (publikimi i materialeve të ndryshme), isomnia - të rinjtë shkurtojnë orët e gjumit dhe ndërrojnë bioritmin e jetës duke qëndruar natën para laptopit shpesh të fiksuar me lojëra ose chat-komunikim me njerëzit. Një person që përdor në mënyrë të tepruar internetin, i shfaqen shenjat/simptomat e njëjta si të të droguarve. Kapaciteti i të menduarit reduktohet/zvogëlohet, gjithashtu sipas të dhënave të mjekëve, ndryshon edhe struktura e trurit, mungon komunikimi sy më sy me njerëzit të gjitha komunikimet bëhen përmes telefonit, ose e-maileve dhe mesazheve, te këta persona që përdorin pa orar internetin shohim shenja hutie, humbje të vëmendjes, nuk janë koherentë pothuajse në asgjë. Gjithashtu keqpërdoruesit cenojnë privatësinë e të tjerëve, thyejnë kodet e kartelave dhe bëjnë sulme e ndërhyrje të paligjshme kibernetike. Në projektin e Elon Musk për vendosjen e impianteve-neorulinkut në trurin e njeriut, filozofi Slavoj Zhizhek thotë: kontrolli i mendjeve njerëzore do ta dehumanizojë njeriun si qenie të tillë dhe ne humbim atë hapësirën minimale të dallimit, apo ndarjes mes “Unë në mendjen time dhe realiteti jashtë kësaj” dhe nuk mund ta dimë çfarë mund të ndodhë n.q.s. kjo distancë bie (S:Zizek).⁶

Dhe teknologjia e përdorur për ta mbajtur të gjallë njeriun, zemrën trurin dhe organet e tjera të dëmtuara ose zëvendësimin e tyre me aparate, është e mirë, por një projekt fillon me kësaj gjëra humane të mira dhe të domosdoshme, ndërkaq në këtë rrugë futen edhe projektet e tjera shkatërruese siç është implanti i neorulinkut që kontrollon njerëzit dhe faktikisht i bën ata robotë që do t'i kontrollojë “pronari i tyre”.

Umberto Eko në një intervistë thotë: Me zëvendësimin e bibliotekave klasike në ato elektronike n.q.s. do të shkatërrohet sistemi teknologjik-interneti nga ndonjë havori e paparashikuar, atëherë biblioteka ime personale prej më shumë se 50 mijë librash do të kishte vlerën e pasurisë së Tutankamunit! Eko këtu tërheq vërejtjen se sistemi elektronik mund edhe të shkatërrohet dhe libri fizik e ka dhe do ta ketë vlerën në të ardhmen si një artefakt arkeologjik për brezin e ardhshëm njerëzor, i cili medoemos duhet ta çmojë dhe vlerësojë.

⁶ Intervistë e Slavoj Zizek <https://www.youtube.com/watch?v=kZJSmUEXU6M>

Konkluzione

Kërkimet që dikur bëheshin me ditë në raftet ose dhomat e periodikëve nëpër biblioteka, tani mund të bëhen brenda disa minutash. Nga disa kërkime të shpejta në Google, në lidhje me librat dhe informacionet që na nevojiten, ne i gjejmë faktet dhe citimet-referencat për hulumtimet tona shkencore.

Interneti është duke u bërë një medium universal, kanal për shumicën e informacioneve që rrjedhin nëpër sytë, veshët dhe në mendjen tonë. Përparësitë e përdorimit të menjëhershëm në një depo kaq të pasur me informacione janë të shumta, ato janë përshkruar dhe duartrokitur gjerësisht siç duhet. “*Rrjeti, mund të jetë një ndihmë e madhe për të menduar.*” Por kjo ndihmë vjen me një çmim. Siç theksoi teoricieni i mediave Marshall McLuhan në vitet 1960, mediet nuk janë vetëm kanale pasive informacioni. Ata formojnë procesin e mendimit. Dhe ajo që duket se po bën interneti është heqja e kapacitetit tim për përqendrim dhe soditje. *Mendja ime tani pret që të marrë informacionin në mënyrën e njëjtë siç e shpërndan rrjeti atë: në rrjedhën e shpejtë të lëvizjes së grimcave. Një herë isha zhytës në detin e fjalëve. Tani ziej përgjatë sipërfaqes si një djalë në një Ski Jet.*⁷

Disponueshmëria e lehtë e librave do të çonte në dembelizëm intelektual, duke i bërë njerëzit "më pak studiues" dhe duke dobësuar mendjen e tyre. Epoka e artë e zbulimit intelektual dhe mençurisë universale, prodhon diçka krejtësisht të ndryshme. Në hapësirat e qeta e të hapura nga leximi i qëndrueshëm, i pandërprerë i një libri, ose nga ndonjë akt tjetër soditjeje, në lidhje me ndonjë hulumtim, ne krijojmë shoqatat tona, nxjerrim konkluzionet, analogjitë dhe nxisim idetë tona.

Ajo që e bën kaq të çuditshme teknologjinë, është problemi emocional i kompjuterit ndaj çmontimit të mendjes njerëzore. Në botën e vitit 2020, njerëzit janë bërë aq të makinizuar sa që personazhi më njerëzor rezulton të jetë një makinë. Ky është thelbi i profecisë së errët të Kubrick: kompjuterët janë duke ndërmjetësuar mirëkuptimin dhe botëkuptimin tonë për botën, ata s'janë asgjë tjetër veçse inteligjenca jonë që përhapet në inteligjencën artificiale.

Leximi në ekran nuk e zëvendëson leximin e librit fizik, por është një zëvendësim i zbehtë i saj, është si të thuash si një ushqim i procesuar në krahasim me një ushqim organik bio. Sa u përket videove, unë mendoj se ato janë më të avancuara se ligjëratat sepse mund t'u kthehem dhe t'i shohim disa herë dhe, në këtë rast përsëritja përforcon kujtesën. Ndërveprimi nëpërmjet internetit me shokët e shkollës, studentët, ose instruktorët ose edhe mes njerëzve që i njohim rritet dhe është pozitiv në veçanti për studentët introvertë. Për grupet më pak të përfaqësuar, mendoj se mësimi digjital është një "shesh lojërash" pozitiv. Edhe për njerëzit e vendeve në zhvillim, mësimi digjital mendoj se është ndihmesë për t'u përballur me pjesëtarët e vendeve të zhvilluara, pra është një mundësi e artë! Kur flasim për mësimin digjital (orë, ligjëratat), që kohëve të fundit po tregohet shumë efikase dhe na jep rezultate të mira, madje edhe të shkëlqyeshme nganjëherë, mendoj se nuk e pengon të menduarit kritik, madje e avancojnë atë, ajo që e pengon është humbja në botën e

⁷ McLuhan, Marshall, (1962), The Gutenberg Galaxy, UNIVERSITY OF TORONTO PRESS, Printed in Canada, Reprinted 1962, f. 162.

rrejshme të lajmeve false dhe “diturisë” së padobishme të rrjeteve sociale, që fatkeqësisht nuk po filtrohen, dhe problemi qëndron te kultura, tradita dhe ndërdija kolektive !

Referencat

- [1]. A Global Encyclopedia of Historical Writing, Volume 2, edited by D.R. Woolf, Garland
- [2]. Bašlar, G. (1969), *Poetika prostora*, Beograd.
- [3]. Čale, F. Flaker, A. (1999), *Povijest svjetske kniževnosti*, Zagreb.
- [4]. Frojd, Z. (1997), *Pesë leksione mbi psikoanalizën*, Tiranë.
- [5]. Frojd, Z. (1997), *Qëndresa dhe shtypja*, Tiranë.
- [6]. Frojd, Z. (1997), *Mbi ëndrën*, Tiranë.
- [7]. Fromm, E. (2006), *Përtej robërisë së iluzioneve*, Tiranë.
- [8]. Genette, G. (1982), *Figures of literary discourse*, New York.
- [9]. Huxley, A. (1963), *Literature and Science*, New York, Harper & Row Publishers
- [10]. Jung, C. (2006) *Psikologjia analitike*, Tiranë.
- [11]. Julien B. (2011), *Treason of the Intellectuals*, Transaction Publishers, New Brunswick (USA) and London, (U.K.), translated by Richard Aldington.
- [12]. Kant Immanuel, (1978), *Um i sloboda*, Nolit, Beograd.
- [13]. McLuhan, Marshall, (1962), *The Gutenberg Galaxy*, UNIVERSITY OF TORONTO PRESS, Printed in Canada, Reprinted 1962.
- [14]. McLuhan, Marshall, (1975), *Understanding Media The extensions of man*, London and New York.
- [15]. Pozzato, M. P. (2005), *Semiotika e tekstit*, Tiranë.
- [16]. Revista shkencore arkeologjike “online” <https://www.archaeology.org/news/2908-150120-herculaneum-papyri-imaging>. <https://www.youtube.com/watch?v=kZJSmUEXU6M>
- [17]. Umberto, E. (1996), *Struktura e papranishme* Dukagjini, Pejë.
- [18]. Žižek, S. (2011), *Did Somebody Say Totalitarianism?* New York, Verso.
- [19]. Žižek, S. (2015), *Trouble in Paradise*, From the End of History to the End of Capitalism. London, Penguin.
- [20]. Woodcock, G. (1972), *Dawn of the Darkest Hour, a study of Aldous Huxley*, London, Faber and Faber.